

**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA****AC-I-22-065..*****Në ankesën e******Paditësi/ankuesi*****A M**, Prishtinë, përfaqesur nga avokat G L, Prishtinë.***Kundër******E paditura*****N.SH''..''** (në likuidim) Prishtinë, të cilën e përfaqëson, **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, Rr. "Dritan Hoxha", nr. 55, Lakrishtë, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtar kryesues, Shkelzen Sylaj dhe, Ilmi Bajrami gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit të paraqitur kundër Aktvendimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-III-18-0041 të datës 04 nëntor 2022, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 02 maj 2024, lëshon këtë:

A K T V E N D I M

- 1. Ankesa e paditësit është e bazuar.**
- 2. Anulohet Aktvendimi i Shkallës së I-rë i DHPGJS-së, C-III-18-0041 i datës 04 nëntor 2022.**
- 3. Lënda kthehet në rigjykim në Shkallë të parë të DHPGJS tek gjyqtari përkatës.**
- 4. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

Rrethanat procedurale dhe faktike:

Me 15 nëntor 2011, paditësi ka paraqitur padi pranë Gjykatës Komunale në Prishtinë, kundër N.SH " ..", për vërtetimin e të drejtës së Pronësisë. Ka kërkuar që gjykata të marrë aktgjykim me të cilin do të vërtetohet se paditësi është pronar i objektit afarist në Prishtinë, lagja.., Objekti afarist "E", lokali nr.., në sipërfaqe prej 2.. ma2, në bazë të Kontratës mbi bashkimin e mjeteve, nr..., të datës .. tetor ...

Me 02 shkurt 2016, Gjykata Themelore në Prishtinë, me Aktvendimin C.nr.2554/11, është shpallur jo kompetente në pikëpamje lëndore dhe lëndën ia ka referuar Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës. Pas plotfuqishmërisë së aktvendimit, lënda është bartur në Dhomën e Posaçme dhe ka marrë shenjën C-III-18-0041.

Më 16 mars 2018, Agjencia Kosovare e Privatizimit, ka paraqitur përgjigje në padi, me të cilën ka propozuar që padia të hedhet si e pa pranueshme apo të refuzohet si e pa bazuar. Ka theksuar se paditësi nuk është thirrur në bazën juridike në të cilën e mbështetet kërkesëpadia dhe se nga kjo rrjedh se padia është parashtruar në kundërshtim me nenin 2...2.4, të Shtojcë së Ligjit nr.04/L-033 për DHPGJS si dhe nenit 253 të Ligjit të Procedurës Kontestimore nr. 03/L-006, pasi që padia nuk përmban elementet thelbësore dhe argumente ligjore në të cilat mbështetet kërkesëpadia.

Me 04 nëntor 2022, Shkalla e I-rë e DHPGJS me Aktvendimin C-III-18-0041 e ka hedhur si të pa pranueshme padinë e paditësit A M të paraqitur më 15 nëntor 2011, kundër N.SH "Novorgadnja", me seli në Prishtinë. Në arsyetim të këtij aktvendimi Shkalla e I-rë ka konstatuar se në bazë të nenit 9.1 të Ligjit për AKP-në, është përcaktuar se: "Bordi mund të iniciojë likuidimin e një ndërmarrje, korporate, asetit ose një pjese të saj, përmes lëshimit të vendimit për likuidim nëse mendon se procedura e tillë është në interes të kreditorëve ose pronarëve përkatës. Procesi i likuidimit do të ushtrohet në bazë të procedurave të

përcaktuara të parapara në Shtojcën e këtij ligji". Me nenin ...2.5 të Shtojcës së Ligjit për AKP-në është përcaktuar se njoftimi për likuidim, përmban informatat si në vijim:..." një deklaratë që vetëm kreditorët e regjistruar dhe bartësit e regjistruar të interesit të përcaktuar të tillë në pajtim me këtë ligj dhe këtë shtojcë, kanë të drejtë të marrin pjesë në shpërndarjen e të hyrave që rezultojnë nga likuidimi i Ndërmarrjes, si dhe vetëm për atë që përcaktohet me këtë ligj dhe këtë shtojcë". Me nenin ...2.6.4 të Shtojcës së ligjit për AKP-në, është përcaktuar se njoftimi për likuidim, përfshinë edhe " një deklaratë të qartë me shkronja të theksuara se të gjitha Kërkesat dhe interesat që nuk janë parashtruar si duhet deri në afatin për parashtrimin e kërkesave do të refuzohen dhe do të jenë përgjithmonë të parashkruara dhe të pa ekzekutueshme".

Shkalla e I-rë e DHPGJS-së ka konstatuar se nga provat e lëndës vërehet se AKP-ja ka publikuar Njoftimin për likuidim, në tri gazeta ditore, konform kriterëve të kërkuara ligjore. Në njoftim janë ftuar të gjithë kreditorët potencial që kërkesat e tyre t'i deponojnë në AKP, më se largu deri më 14 gusht 2011, me njoftimin se subjektet që nuk e respektojnë këtë afat, mund të mos përfshihen në ndarjen e fondeve që do të krijohen nga likuidimi. Shkalla e I-rë ka konstatuar se paditësi, me paraqitjen e padisë drejtpërdrejtë në Gjykatë, e ka anashkaluar AL-si organ kompetent për të shqyrtuar kërkesën pronësore të tij. Përveç kësaj, është shkelur edhe afati për dorëzimin e kërkesave kreditore dhe të interesit ishte data 14 gusht 2011. Pala paditëse e ka deponuar padinë drejtpërdrejtë në gjykatë, tre muaj më vonë, respektivisht me datën 15 nëntor 2011. Duke u bazuar në këto rrethana Shkalla e I-rë ka konstatuar se pala paditëse nuk e ka parashtruar kërkesën pronësore në AL, por në Gjykatë dhe atë pas kalimit të afatit për parashtrimin e kërkesave pronësore. Prandaj, në këtë rast është i zbatueshëm neni ...2.6.4 i Shtojcës së ligjit për AKP-në, i cili përcakton se :të gjitha kërkesat dhe Interesat që nuk janë parashtruar si duhet deri në afatin për parashtrimin e kërkesave do të refuzohen dhe do të jenë përgjithmonë të parashkruara dhe të pa ekzekutueshme". Andaj në bazë të nenit 36 të Ligjit për Dhomën e Posaçme është përcaktuar se ankesa/padia hedhet si e pa pranueshme, nëse nuk është në pajtim me nenin 33 të këtij ligji.

Me 02 dhjetor 2022, paditësi/ankuesi nëpërmjet përfaqësuesit e dorëzoi në DHPGJS një ankesë kundër Aktvendimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS, C-III-18-0041 të datës 04 nëntor 2022, për të gjitha bazat ankimore dhe kërkon nga Kolegji i Apelit, të aprovohet ankesa si e bazuar, të ndryshohet Aktvendimi i ankimuar, ashtu që Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme vet të vendos çështjen, duke e aprovuar kërkesëpadinë e paditësit në tersi si të bazuar dhe të vërtetoje se paditësi A M është pronar i lokalit që gjendet në Prishtinë në Lagjen.., objekti afarist "E", lokali me numër .. me sipërfaqe prej 2.. m2.

Paditësi/ankuesi në ankesën e parashtruar konsideron se aktvendimi ka shkelje të natyrës proceduralo-juridike për faktin se vlerësimi i Shkallës së I-rë nuk është i bazuar në prova që gjenden në shkresat e lëndës dhe po ashti ka shkelje të natyrës proceduralo-juridike, material-juridike dhe konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Ankuesi thekson se shkalla e I-re gabimisht është thirrur në nenin ...2.6.4 të Shtojcës së Ligjit për AKP-në dhe ka përdorë si bazë juridikë për ta hedhë si të pa pranueshme padinë e paditësit për arsye se kjo dispozitë i referohet dhe i parasheh pasojat e mos paraqitjes së kërkesave në kohë, vetëm në AKP-në përkatësisht Autoritetin e Likuidimit, e kurrresi nuk ka efekt të Gjykata për provueshmërinë e padisë së paditësit. Paditësi/ankuesi thekson i është drejtuar gjykatës me padi për vërtetimin e pronësisë, mbi bazën e punës juridike respektivisht Kontratës bashke investuese, si i vetmi institucion për vërtetimin e pronësisë, pasi që AKP-ja respektivisht Autoriteti i Likuidimit, nuk ka kompetencë për ta vërtetuar apo njohur pronësinë ndonjë pronari eventual por kompetencë e tij është likuidimi i Ndërmarrjes Shoqërore me të gjitha asetet, por kurrresi vërtetimi i pronësisë.

Paditësi/ankuesi po ashtu konsideron se Aktvendimi i Shkallës së I-rë ka shkelje të natyrës materialo-juridike, pasi që padia për vërtetimin e pronësisë është padi që nuk i nënshtrohet afatit të parashkrimit, prandaj personi me interes mund ta ushtrojë në një padi të tillë në momentin që bije në dijeni se i takon një e drejtë të tillë. Në Ligjin për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore, neni 1 paragrafi 1, thuhet se ky ligj rregullon krijimin, përmbajtjen, bartjen si dhe shuarjen e të drejtave sendore të kufizuara si posedimin, të drejtat sendore të sigurimit...etj. Në kuptim të kësaj dispozite pronësia është e drejtë sendore si andaj siç dihet të

drejtat sendore nuk i nënshtrohen afateve kohore të parashkrimit, duke u bazuar në nenin .. të njëjtit ligj, ku tekstualisht thuhet se të drejtat sendore nuk parashkruhen, përveç ashtu siç përcaktohen me ligj. Padiësi/ ankuesi konsideron se Shkalla e I-rë gabimisht e ka zbatuar këtë të drejtë materiale, sepse i jep përparësi për vendimmarrje Ligjit për AKP-në që është ligj procedural për çështjen, ndërsa anashkalon Ligjin për Pronësinë që është Ligj primar dhe special për fitimin e pronësisë. Po ashtu padiësi/ ankuesi konsideron se Shkalla e I-rë ka bërë konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike për shkak se me rastin e vendosjes si të pa pranueshme padinë e padiësit, ka anashkaluar dy prova vendimtare për çështjen, siç janë Kontrata për bashkimin e mjeteve për ndërtimin e lokaleve afariste me të paditurën “..”, nr.25/10 e datës 15 tetor 1995 dhe Vërtetimin e lëshuar nga vet e paditura në vitin 1996, mbi bazën e së cilit vërtetohet se padiësi i ka përmbush të gjitha detyrimet që lidhen me pagesën e lokalit kontestues. Me kontratën për bashkë investim vërtetohet fakti se padiësi me rastin e shpalljes në likuidim të pronës Ndërmarrjes “..” dhe ti bartë pronësinë përmes rrugës administrative, pasi që AKP-ja ka qenë në dijeni ose të paktën ishte dashur të këtë dijeni, se ekziston kontrata bashke investuese mes padiësit dhe të paditurës për lokalin kontestues dhe se të gjitha obligimet për pagesën e lokalit i ka përmbush padiësi të gjitha detyrimet që lidhen me pagesën e lokalit kontestues. Padiësi/ankuesi thekson se me kontratën për bashkë investim vërtetohet fakti se padiësi e ka statusin e bashkëpronarit në lokalin kontestuese së bashku me N.SH “..” dhe AKP-ja, si menaxhuese e pronës së N.SH “..” është dashur ta konsultoj edhe padiësin me rastin e shpalljes së likuidimit të pronës Ndërmarrjes “..” dhe ti bartë pronësinë përmes rrugës administrative, pasi që AKP-ja ka qenë në dijeni dhe se të gjitha obligimet për pagesën e lokalit i ka përmbush padiësi. Padiësi me ankesë ka bashkangjitur autorizimin për përfaqësim nga avokati, kontratën për bashkimin e mjeteve për ndërtimin e lokalit afarist dt. .. tetor ..., vërtetimin për përmbushjen e obligimeve ndaj NSH-së “..” që rrjedhin nga kontrata për bashkimin e mjeteve për ndërtimin e lokalit afarist.

Me 15 dhjetor 2023, AKP-ja ka parashtruar përgjigje ndaj ankesës se padiësit/ ankuesit dhe ka propozuar që të refuzohet në tersi si e pa bazuar ankesa e

paditësit/ankuesit dhe të Vërtetohet Aktvendimi i Kolegjit të Specializuar të Dhomës së Posaçme. AKP-ja në ankesën e parashtruar thekson se paditësi nuk ka arrit të paraqesë ndonjë bazë juridike të besueshme, dhe se nuk ka mundur të konstatojë një gjendje tjetër faktike prej asaj siç ka vërtetuar Shkalla e I-rë e DHPGJS-së me aktvendimin e atakuar. AKP-ja konsideron se paditësi nuk ka parashtruar kërkesën pronësore në AL, por në Gjykatë dhe atë pas kalimit të afateve për parashtrimin e kërkesave pronësore, duke zbatuar ...2.6.4 të Shtojcës së ligjit për AKP-në, si dhe nenit 36 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, ku është përcaktuar se ankesa/padia do të hedhet si e pa pranueshme nëse nuk është në pajtim me nenin 33 të këtij ligji. AKP-ja thekson se argumentet e theksuara janë të pa bazuara sepse mungojnë argumentet ligjore apo dëshmitë dhe si të tilla nuk mund të prodhojnë ndonjë efekt juridik.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa e paditësit është e bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Aktvendimi i ankimuar i Shkallës së I-rë i DHPGJS-së nuk është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj duhet të anulohet dhe lënda të kthehet në rigjykim.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi më 15 nëntor 2011, ka paraqitur padi pranë Gjykatës Komunale në Prishtinë, kundër N.SH " ..", për vërtetimin e të drejtës së Pronësisë. Me padi ka kërkuara nga gjykata të marrë Aktgjykim me të cilin do të vërtetohet se paditësi është pronar i objektit afarist në Prishtinë, lagja.., Objekti

afarist "E", lokali nr..., në sipërfaqe prej 2.. ma2, në bazë të Kontratës mbi bashkimin e mjeteve, nr...., të datës .. tetor

Kolegji i Apelit vëren se me 20 janar 2016, AKP përmes shkrese informuese lidhur me statusin juridike të Ndërmarrjes "..", me seli në Prishtinë, e kishte njoftuara Gjykatën Themelore të Prishtinës se NSH "..", i ishte nënshtruar procesit të Likuidimit me 30 maj 2011. Po ashtu Kolegji vëren se AKP, qysh në vitin 2011, kishte kërkuara nga Gjykata Komunale në Prishtinë ndërprerjen e të gjitha çështjeve juridike kundër NSH-së " ..", meqë N.Sh në fjalë kishte hyr në Likuidim.

Me 02 shkurt 2016, Gjykata Themelore në Prishtinë, me aktvendimin C.nr.2554/11, është shpallur jo kompetente në pikëpamje lëndore dhe lëndën ia ka referuar Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DHPGJSK).

Shkalla e I-rë e DHPGJS me Aktvendimin C-III-18-0041 të dt. 04 nëntor 2022, e ka hedhur si të pa pranueshme padinë e paditësit, me arsyetim se paditësi me paraqitjen e padisë drejtpërdrejtë në Gjykatë, ka anashkaluar Autoritetin e Likuidimit si organ kompetent për të shqyrtuar kërkesën pronësore të tij. Pra është shkelur afati për dorëzimin e kërkesave kreditore dhe të interesit që ishte data 14 gusht 2011. Paditësi e ka deponuar padinë drejtpërdrejtë në gjykatë, tre muaj më vonë, respektivisht me datën 15 nëntor 2011.

Kolegji i Apelit vlerëson se edhe pse AKP e kishte informuara me kohë Gjykatën Komunale në Prishtinë qysh në vitin 2011, se NSH "..", kishte hyr në Likuidim dhe kishte kërkuar që të pezullohet procedurën në këtë çështje juridike, gjykata nuk ishte vendosur lidhur me pezullimin e procedurës, në mënyrë që paditësi ti drejtohej AL. I gjetur në një situatë të tillë në pritje të një Vendimi nga Gjykata, për shkak se rasti i tij asnjëherë nuk ishte pezulluar, paditësi tashmë kishte krijuar pritshmëri të mirëqena ligjore se Gjykata do të nxjerrë një vendim për çështje meritore, e jo për tu hedhur padia e tij si e papranueshëm pas më shume se 11 vite. Paditësi tani më ka humbur të gjitha afatet për paraqitjen e kërkesë para

Autoritetit të likuidimit. Në bazë të shkresave të lëndës nuk ka të dhen për ndonjë lëndë aktive që i referohet paditësit tek AL.

Është e qartë se paditësi ka dështuar të kërkojnë të drejtën e tij tek AL ndaj NSH-së në procedurë të likuidimit, por duhet të kihet parasysh që padia për vërtetimin e pronësisë nuk mund të hedhet poshtë si e papranueshme siç ka vepruar Shkalla e I-rë. Në një rast të tillë do ti mohohet paditësit e drejta për qasje në Gjykatë si dhe mbrojtje gjyqësore. Kolegji i Apelit vlerëson se interesi për të ushtruar padi për një çështje pronësore mund të lindë edhe pasi që N.Sh ka hyrë në likuidim dhe të ketë kaluar afati për paraqitjen e kërkesës kreditore në AL, prandaj për çështjet pronësore situata është me ndryshe se sa tek çështjet që kanë të bëjnë me kërkesat monetare.

Kolegji i Apelit po ashtu gjen se Shkalla e I-rë me rastin e marrjes së Aktvendimit ka shkelur edhe dispozitën e Ligjit për Dhomën e Posaçme, përkatësisht nenit 9.3 lidhur me nenin 4 paragrafi 9 të Ligjit nr.06/L086 ku përshihet se kërkesat në lidhje me procesin e privatizimit dhe kërkesat pronësore shqyrtohen dhe gjykohen në Shkollë të parë, nga një Kolegj i specializuar i përbërë nga 3 gjyqtarë. Në këtë lëndë çështja juridike e paditësit është një çështje pronësore me shenjen C-III.-18-0041 dhe lënda është dashur të vendoset në kolegji prej 3 gjyqtareve të Shkollës së I-rë e jo nga një Gjyqtar individual.

Prandaj nga këto arsye, Kolegji i Apelit vlerëson se ankesa e paditësit është e bazuar mbi arsyet e cekura më lartë dhe Aktvendimi i ankimuar nuk është saktë dhe i drejtë e si i tillë duhet të anulohet dhe lënda të kthehet në rigjykim në Shkallë të I-rë.

Andaj në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, është vendosur sikurse në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

Taksat gjyqësore

Ankuesi tashmë e ka paguar taksën gjyqësore për procedurën ankimore, në shumë prej 100 euro, me datë 19 dhjetor 2022, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 02 maj 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar kryesues
